

Emrat përmbledhës në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980)

Mr. Agim Spahiu

7 prill 2009

Përmbledhje

Me anë të programeve të linux-it kemi arritur t'i përfshijmë të gjithë emrat përmbledhës që janë përfshirë në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe të vitit 1980. Dhe nga to kemi sajuar, si të thuash, një fjalorth të këtyre lloj emrave në gjuhën shqipe.

Midis emrave të përgjithshëm dallohen si një grup i veçantë, për veçoritë e tyre leksikore dhe gramatikore, *emrat përmbledhës*. Emrat përmbledhës emërtojnë një tërësi vetash, kafshësh ose sendesh të një fare, në formën e numrit njëjës. Ndryshe nga emri i numrit shumës, emri përmbledhës emërton një shumicë sendesh të njëlojta si një tërësi të pandarë dhe, nga pikëpamja sasiore, të panumërueshme. Në të dyja rastet kemi të bëjmë me shumësi, por, ndërsa te forma e numrit shumës shumësia paraqitet e diferencuar, e ndashme në njësi, tek emri përmbledhës ajo merret si një e tërë e pazbërthyeshme. Kjo del e qartë kur krahasojmë format e numrit shumës të disa emrave me emrat përmbledhës që janë formuar prej tyre: djemtë, dy djem, tre djem - djalëria; gratë, dy gra, tri gra - graria; proletarët, dy proletarë, tre proletarë - proletarët¹.

Në këtë shkrim, kemi synuar që, me anë të programeve të caktuara të linux-it, t'ua prezantojmë lexuesve një Fjalorth të emrave përmbledhës nga Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, të cilin nuk ka pasur mundësi ta ketë në dorë në një mënyrë të përmbledhur deri më sot.

ADMINISTRATË f. 3. përmb. Tërësia e nëpunësve, që veprojnë në aparatit shtetëror ose në një njësi organizative shtetërore. Administrata e fabrikës (e institutit). Shkurtoj administratën.

AFRI f. 4. përmb. bised. Të afërmit, farefisi. U mblohdh afria.

AGALLARI f. përmb. vjet. Tërësia e agal-

larëve, agallarët.

AGJENTURË f. 2. përmb. Tërësia e agjentëve të organeve të zbulimit të një shteti të huaj. Agjunkturë e fshehtë. Zbuloj (kap, asgjësoj) agjunkturën.

AHENG m. bised. përmb. gazet popullore. Këngë ahengu. Bëj (hap, ngre) aheng. Shkoi për aheng. Mori aheng për dasmë.

¹Kështu janë përkufizuar emrat përmbledhës në tekstin *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, të ASHSH, botim i vitit 2002, f. 83.

- AKRABA** f. thjeshtligj., vjet. 1. përmb. Farefisi, rrethi familjar, gjaku e gjinia. E ka akraba. Ka shumë akraba. Mbledh akra-banë.
- AKUAREL** m. art. përmb. tërësia e piktu-rave të tilla në një galeri artesh, në një ekspozitë etj. Akuarelet e një piktori.
- ANDRI** f. përmb. Almiset për të lëruar tokën dhe për të ngarë qetë.
- ANIJESI** f. përmb. vjet. Flota detare. Anijesi luftarake.
- ANTROPONIMI** f. gjuh. 1. përmb. Tërësia e emrave të përveçëm të njerëzve në një gjuhë a te një popull.
2. Degë e gjuhësisë, që studion emrat e përveçëm të njerëzve. Antroponimia shqiptare.
- APARATURË** f. përmb. Tërësia e aparat-eve dhe e pajisjeve të ndryshme, që krye-jnë një punë së bashku ose që përdoren në një laborator, në një repart prodhimi etj. Aparaturë elektrike (kimike). Ndrej aparaturën.
- ARGATËRI** f. hist. 1. përmb. Tërësia e ar-gatëve, argatët; shtresa e argatëve.
- ARGJENDARI** f. 3. përmb. Sendë e stoli prej argjendi, argjendurina.
- ARMIK** m.
3. përmb. Ushtria kundër së cilës bëhet lufta dhe shteti, të cilit i shërben ajo, kundërshtari. Forcat e armikut. Ushtria e armikut. Planet e armikut. Sulmon (dërrmon) armikun.
- ARMIQËRI** f. përmb. bised. Të gjithë armiqtë së bashku.
- ARNI** f. përmb. krahin. Tërësia e arave, të gjitha arat së bashku; arnajë.
- ARTILERI** f. usht. 1. përmb. Tërësia e arma-timeve luftarake, që përbëhet nga armë zjarri të rënda (si topat, obusët, morta-jat etj.), të cilat kanë kalibër me të madh se pushka e mitralozi; tërësia e këtyre ar-mëve që ka një ushtri ose një njësi. Arti-leria e lehtë (e rëndë). Artileria kundëra-jrore (bregdetare, kundërtanke). Artile-ria reaktive. Qitje artilerie. Zjarri i arti-lerisë. Përgatitje artilerie goditje me arti-leri para sulmit. Zbulim artilerie. Qëlloj (godit, rrah) me artileri.
- ASORTIMENT** m. 2. vet. nj. përmb. Tërësia e llojeve të prodhimeve ose të mallrave, që nxjerr një ndërmarrje. Plani i asortimenteve. Plotësimi si asortiment.
- ASQER** m. vjet. 3. vet. nj. përmb. Ushtri.
- AUDITOR** m. 2. përmb. Tërësia e dëgjuesve të një leksioni, të një referati etj., zakon-isht të mbledhur në një sallë. Auditor i gjerë (i ngritur). Shumica e auditorit. Flas përpara një auditori.
- BAGËTI** f. 1. përmb. Kafshët shtëpiake, që mbahen për prodhimet e tyre dhe për punë bujqësore, gjë e gjallë; një kaf-shë e tillë shtëpiake. Bagëti e trashë lopët, qetë dhe buajt. Bagëti e imët (e hollë) dhentë e dhitë. Bagëti të leshta. Njëzet krerë (kokë) bagëti. Pleh (lëkurë) bagëtish. Ahur (kasolle) bagëtish. Kope (tufë) bagëtish. Pazari i bagëtive. Lëshoj (kullot, dimëroj) bagëtinë. Shkon me bagëti. Njeriu pa dituri është pors bagëti. fj. u.
- BAR** I m. përmb. tërësia e bimëve të këtij lloji, që rriten vetë në livadhe, në ara etj.; mbulesa e gjelbër me këto bimë; lënd-inë. Bar i gjelbër. Bar i njomë (i ri, i thatë). Bar i egër bimë barishtore që mbijnë e rriten vetë. Bar i dendur. Bar hel-mues (i kripur). Bar mali (kënetë). Bar vjeshte.
- BARNI** f. përmb. Tërësia e barërave; bar-ishtet.
- BASHKËRI** f. 2. përmb. Shokë e miq, shoqëri. Kemi bashkëri.
- BATAK** m. përmb. fundërrinat e shoqërisë, llumi. Bataku i shoqërisë.
- BEJLLËK** m. 2. përmb. bised. Tërësia e be-jlërëve, bejlerët.

- BEQARI** f. 2. përmb. Tërësia e beqarëve, të rriturit e pamartuar. Ishte mbledhur beqaria.
- BIJËRI** f. 1. përmb. Tërë bijtë e bijat, djemtë e vajzat e dikujt. U mblodh bijëria.
- BIJIM** m. 2. përmb. Të gjithë fëmijët e lindur nga dy bashkëshortë; brezni.
- BINA** f. bised. 3. përmb. bised. Bijtë e bijat, fëmijët; pasardhësit e një njeriu. Baba pa bina.
- BISHË** f. përmb. Grup njerëzish gjakatarë. Bisha fashiste.
- BIZHUTERI** f. përmb. Tërësia e sendeve të vogla prej lënde të çmueshme ose të punuara hollë, që përdoren si stoli. Bizhuteri ari. Artikuj bizhuterie. Reparti (dyqani) i bizhuterisë.
- BLEGTORI** f. 2. përmb. shih BAGËTI, A I. Blegtori e imët. Kullotë për blegtori.
- BLERIM** m. 2. përmb. Tërësia e bimëve të blerta që mbulojnë tokën, gjelbërim. Qytet (kodra, fusha) plot blerim. Në mes të blerimit. U vesh toka me blerim.
- BLETË** f. 2. përmb. Tërësia e këtyre mizave, që rrojnë si familje në një zgjua; zgjoi ku rrinë këto miza. Lëshon (roit, hedh) bleta. Pres (mbyt, vras, qeth) bletën. Gumëzhijnë si bleta. Vjen si bletë e plotë.
- BLOZËRI** f. përmb. Mbeturina të papastra.
- BONJAKËRI** f. 2. përmb. Tërësia e jetimëve, jetimët. 3. përmb. fig. vjet. Të varfrit.
- BOSTAN** m. përmb. shalqi e pjepër. Boston farëvogël (i ëmbël, dimërak). Farë bostani. Mbjeell bostan. Çahet si bostan.
- BOTË** I f. 4. përmb. bised. Njerëzit e tjerë, gjindja që na rrethon, njerëzia; njerëzit e huaj, me të cilët nuk kemi të bëjmë; një njeri tjetër, dikush. Gjithë bota. Si gjithë bota.
- BRESHKAMADH** m. përmb. vet. një përmb. pushtuesit italianë. Zjarr e plumb mbi breshkamadhin! E dëbuam (e përzumë) breshkamadhin.
- BRIKET** m. përmb. lënda e ngjeshur në këtë mënyrë. Briket qymyri. Briket tallashi. Briket çeliku. Stufë për briket. Bëj briket. Përdor briket.
- BRIKETË** f. përmb. lënda e ngjeshur në këtë mënyrë. Briket qymyri. Briket tallashi. Briket çeliku. Stufë për briket. Bëj briket. Përdor briket.
- BUBËRRI** f. përmb. Tërësia e punëve të vogla, vogëlsirat, çikërrimat. Merret me bubërri.
- BUJQËRI** f. përmb. Tërësia e bujqve, fshatarët që merren me bujqësi.
- BUROKRACI** f. 2. përmb. Tërësia e nëpunësve që bëjnë pjesë në aparatën burokratik të një shteti, burokratët.
- BURRËRI** f. 2. përmb. Tërësia e burrave të një vendi, të një shtëpie etj., burrat. Burrëria e fshatit. Burrëria e shtëpisë. U mblodh burrëria.
- ÇAKËLL** m. 1. përmb. Gurë të thyer në copa të vogla, që përdoren zakonisht për të shtruar rrugët. Grumbull çaklli. Çekan çaklli. Rrugë me çakëll. Shtroj me çakëll. Hedh (ngjesh) çakllin.
- ÇATMA** f. 2. përmb. Dërrasa të holla ose thupra, që përdoren si lëndë për mure të holla; petavra. Mur me çatma. Tavan me çatma.
- ÇERDHE** f. 7. përmb. Të vegjlit e një kafshe shtëpiake që kanë lindur dhe që rriten së bashku. Çerdhja e gicave.
- ÇIFUTËRI** f. përmb. bised. Tërësia e çifutëve gjithë çifutët. U mblodh çifutëria.
- ÇOBANËRI** f. përmb. 1. Tërësia e çobanëve, gjithë çobanët, barinjtë. U mblodh çobanëria.
- ÇOBANI** f. 2. përmb. Çobanëri. Erdhi çobania.
- ÇUNËRI** f. bised. 2. përmb. Tërësia e çunave, djemuria. U mblodhën çunëria.
- ÇUPËRI** f. 2. përmb. Tërësia e çupave, gjithë çupat, vajzëria. U mblodh çupëria. Rri në mes të çupërisë.

- DATËLINDJE** f. 3. përmb. usht. Ata që kanë lindur në të njëjtin vit dhe thirren për të kryer shërbimin ushtarak në një kohë të caktuar. U thirrën dy datëlindje. Këtë datëlindje nuk e thirrën sivjet.
- DEFTER** m. 3. përmb. bised. Tufë me pesëdhjetë fije letrash cigareje, të lidhura së bashku.
- DELMERI** f. përmb. Barinjtë, çobanëria.
- DERRËRI** f. përmb. 1. Tërësia e derrave, der-rat.
- DJALËRI** f. 2. përmb. Tërësia e djemve, të gjithë djemtë e një vendi, të një fshati etj. Djalëria shqiptare. Djalëria e fshatit. Lulja e djalërisë. U mblodh djalëria.
- DRAMATURGJI** f. 2. përmb. Tërësia e veprave letrare dramatike të shkruara nga një shkrimtar ose nga disa shkrimtarë, në një epokë a në një vend të caktuar etj. Dramaturgjia shqiptare. Dramaturgjia e lashtë.
- DREJTËSI** f. 3. përmb. Tërësia e organeve që mbrojnë rendin juridik në një vend të caktuar; sistemi i institucioneve që merren me dhënien e drejtësisë; veprimtaria e organeve gjyqësore që mbështetet në ligjshmërinë, në të drejtën në fuqi. Organet e drejtësisë. Dora e drejtësisë. libr. organet gjyqësore popullore. Shpata e drejtësisë. libr. ndëshkimi që jepet nga gjykatat popullore për një tradhtar.
- DUSHK** m. 3. përmb. Degë të vogla me gjithë gjethe, të prera prej këtij druri, që grumbullohen për dimër si ushqim për bagëtinë. Mullar me dushk. Preu (bëri, vuri) dushk. I ushqen me dushk.
- DY** num. them. 2. përmb. (të), JA (të). Dy së bashku a menjëherë. Erdhën të dy shokët (të dyja shoqet). Ia dhashë të dy librat.
- DHE** m. 8. vet. nj. përmb. bised. Tërësia e njerëzve që jetojnë në një vend, në një krahinë, në një qytet a në një fshat; populli, popullsia. U mblodh gjithë dheu. U ngrit në këmbë tërë dheu.
- DHËNDËRI** f. 2. përmb. Dhëndurët e një familjeje. U mblodh (erdhi) dhëndëria. Thirri dhëndërinë për darkë.
- DHIRI** f. përmb. Kope me dhi, kope dhish. Doli dhiria nga pylli.
- DHJETË** num. them. 2. përmb. DHJETË (të), DHJETA (të). Dhjetë (frymorë, sende, etj.) të marrë së bashku, dhjetë bashkë.
- EGËRTI** If. përmb. Tërësia e kafshëve të egra, egërsirat. Ka egërti në mal. I hëngri egërtia.
- ELITË** f. përmb. libr. Pjesa më e lartë e më e privilegjuar e klasave, e shtresave, a e grupeve shoqërore sunduese në vendet borgjeze e revizioniste përkundrajt klasave e shtresave të shtypura dhe njerëzve të thjeshtë; pjesa më e mirë e më e zgjedhur e një tërësie. Elita e privilegjuar. Elita e shoqërisë (e vendit). Elita e intelektualëve (e ushtrisë). Përfaqësuesit e elitës.
- EMIGRACION** m. 2. përmb. Njerëzit që kanë emigruar. Emigracioni politik (ekonomik).
- EVGJITËRI** f. përmb. Tërësia e evgjitëve, evgjitët.
- FAKIRFUKARA** m. bised. 1. përmb. Shtresa me e varfër e popullsisë në vendet kapitaliste, që shtypet e shfrytëzohet në mënyrën me të egër, të varfrit, të këputurit. Plaçkitin fakirfukaranë. S'çajnë kokën për fakirfukaranë.
- FAKULTET** m. përmb. bised. studentët dhe punonjësit që bëjnë pjesë në të. Fakulteti i Historisë e i Filologjisë (i Shkencave të Natyrës, i Gjeologjisë). Dekani i fakultetit. Degët (katedrat) e fakultetit. Mbaroi (kreu) fakultetin. U rreshtuan para fakultetit. I gjithë fakulteti shkoi në aksion.
- FAREFIS** m. 1. përmb. Tërësia e njerëzve që kanë lidhje gjaku ose gjinie, njerëzit e afërm.

- FAREFISNI** f. 2. përmb. Tërësia e njerëzve që kanë lidhje gjaku a gjinie ndërmjet tyre, farefis. Erdhi me tërë farefisninë e tij.
- FARË** f. 2. përmb. Kokrrat me të mira e të zgjedhura të drithërave, të perimeve etj., që përdoren për të mbjellë. Farë e zgjedhur. Farë vendi. Farë misri (gruri). Farë qepe (duhani). Farë jonxhe. Zgjedhja e farës. Hedh farën. Ruaj (lë) për farë. 9. përmb. Grup njerëzish që kanë lidhje gjaku nga babai; pasardhës, pinjoll. Farë e shtueshme. Farë e keqe (e ligë). shar. Me soj e me farë me gjithë farefisninë. I humbi fara. I humbtë (iu shoftë, i daltë) fara! mallk. Mos i mbiftë fara! mallk. Mos lëntë farë pas! mallk. 10. përmb. bised. Grup njerëzish të një kombi a të një race. Farë shqiptare. Fara me e vjetër në Evropë.
- FEMËRI** f. përmb. Tërësia e femrave, gratë dhe vajzat. Gjithë femëria.
- FËMIJËRI** f. 2. përmb. Të gjithë fëmijët së bashku, fëmijët. U mblodh fëmijëria.
- FILIZËRI** f. përmb. libr. Tërësia e filizave të drurëve a të bimëve, filizat.
- FISNIKËRI** f. 2. përmb. hist. Shtresa me e lartë dhe me e privilegjuar e klasës shfrytëzuese në shoqërinë feudale ose feudalo-borgjeze, aristokracia feudale; tërësia e fisnikëve; parësia, shtresa me e lartë e një fisi. Fisnikëria feudale.
- FOSH NJËRI** f. 2. përmb. Tërësia e foshnjave, foshnjat.
- FQINJËRI** f. 1. përmb. Njerëzit që banojnë afër me njëri-tjetrin, fqinjët. U mblodh fqinjëria.
- FRUTOR** mb. 2. si em. f. vet; sh. E, ET përmb. Drurët frutorë, pemët.
- FSHAT** m. 2. përmb. Tërësia e banorëve të kësaj qendre; fshatarët. U mblodh (u ngrit) i gjithë fshati.
- FSHATARËSI** f. 1. përmb. Popullsia që banon në fshat dhe që merret kryesisht me bujqësi e me blegtori. Fshatarësia e fushës (e zonave malore). U mblodh fshatarësia.
- FUKARA** f. përmb. bised. Tërësia e të varfërve, njerëzit e varfër. Erdhën ditë të mira për fukaranë.
- FURNIZIM** m. 2. përmb. bised. Mallrat e ndryshme e sendet e nevojshme, me të cilat furnizohet një ndërmarrje për të plotësuar kërkesat e punës ose një dyqan për t'i shitur. Erdhi furnizimi.
- FUSHË** f. përmb. tërësia e letrave që mbeten mbi tryezë gjatë lojës. Marr (ngre) nga fusha.
- GALANTERI** f. 1. vet. nj. përmb. Sendet të imëta prej lëkure, prej metali, prej plastike etj. si çanta, dorashka, rripa mesi, rripa orësh, karfica, furça, krehra, etj. Artikuj galanterie. Punishte (dyqan) galanterie.
- GALTINË** f. përmb. Copa gurësh, tullash, suvaje etj. që bien kur shembet një mur.
- GARDËROBË** f. përmb. rrobat që mbahen në këtë dollap; të gjitha rrobat e sipërme vetjake që ka dikush. Gardërobë e madhe (e vogël). Gardërobë me pasqyrë. Gardërobë e pasur.
- GËRDHAJË** f. 2. përmb. keq., vjet. Klasat ose shtresat e shtypura e të shfrytëzuara, turma e paditur (përdorej nga shfrytëzuesit).
- GËRDHAM** m. 3. përmb. Plehra; diçka e përzier dhe e papastër.
- GËRRESË** f. 2. përmb. Të kruarat e një gjelle që është ngjitur në enë.
- GRAFIKË** f. përmb. tërësia e këtyre veprave. Grafikë e lirë (e zbatuar). Grafika shqiptare. Ekspozita e grafikës.
- GRARI** f. përmb. Gjithë gratë, tërësia e grave të një shtëpie, të një fshati etj. Graria e fshatit. U mblodh graria. Filloi këngën graria.
- GRAVURË** f. art. përmb. tërësia e veprave të këtij lloji. Gravurë e bukur. Gravurë me ngjyra. Ekspozita e gravurës.
- GJALLËSI** f. 2. përmb. Tërësia e qenieve të gjalla.

- GJASHTË** num. them. 2. përmb. (të), GJASHTA (të). Gjashtë së bashku a menjëherë. Dolën të gjashtë nxënësit.
- GJEDH** m. dhe përmb. Bagëti e trashë. Gjehët e mishit. Gjehët e qumështit. Mish gjedhi. Sëmundje e gjedhit. Zhvillimi (shtimi, përmirësimi) i gjedhit.
- GJELBËRIM** m. 2. përmb. Tërësia e bimëve të njoma dhe e drurëve me gjethe, blerim; bimësi.
- GJETH** m. 2. përmb. Tërësia e gjetheve të pemëve a të bimëve. Çeli (doli) gjethi. I ra gjethi. Era e gjethit erë e lehtë pranverore që fryn në kohën kur çel gjethi. 3. përmb. Degët e holla me gjethe të disa drurëve, që përdoren si ushqim për bagëtinë; ushqim prej bimësh për bagëtinë. Gjeth dushku. Bëjnë gjeth. Presin gjeth. Mullar me gjeth.
- GJETHE** f. 2. përmb. shih GJETH, I 2, 3. Çeli gjethja.
- GJETHISHTË** f. 1. vet. nj. përmb. Gjethe të rëna e të shtruara për tokë. Gjethishtë e butë. Kaluan mbi gjethishtë.
- GJETHNAJË** f. 1. Kurora e gjetheve të një peme; përmb. gjethet e një druri. Gjethnaja e pemëve. Gjethnaje e dendur.
- GJINDE** f. përmb. bised. Tërësia e njerëzve, zakonisht të një qendre të banuar, populli. Gjindja e fshatit. Gjindja e shtëpisë njerëzit e familjes, gjindtë. U mblodh gjindja. Kishte gjindje të madhe.
- GJYKATË** f. 2. përmb. drejt. Gjyqtarët dhe ndihmësgjyqtarët që shqyrtojnë një çështje gjyqësore; trupi gjykues.
- GJYQTARI** f. përmb. 1. sport. Tërësia e gjyqtarëve që ndjekin zbatimin e rregullave të lojës a të garës sportive. Gjyqtaria qendrore.
- GJYSHËRI** f. 1. përmb. Tërësia e gjyshërve, gjyshërit; stërgjyshërit.
- HAJDUTËRI** f. 1. përmb. Tërësia e hajdutëve, hajdutët.
- HALLDUPËRI** f. përmb. vjet. Pushtuesit osmanë; tradhtarët vendas, që mbanin anën e pushtuesit osman. E shporrën halldupërinë.
- HALLK** m. përmb. bised. Njerëzia, bota, njerëzit. Punët e hallkut. Ç'është hallku. Fjalët e hallkut e vrimat e gardhit s'mbyllen kurrë. fj. u.
- HARBUTËRI** f. 1. përmb. vjet. Njerëzit e vegjëlisë a të klasave të shfrytëzuara të shoqëris ë(përdorej me përbuzje nga klasat shfrytëzuese). 2. përmb. Sjellje e keqe prej harbuti; qëndrim i vrazhdë e i rëndë.
- HAREM** m. 2. përmb. Gratë dhe dashnoret e myslimanëve të pasur, që rrinë në një banesë të veçantë. Haremi i sultanit (i pashait). Merrte haremin me vete.
- HASMËRI** f. 3. përmb. bised. Armiqtë. Gjithë hasmëria.
- HUBI** f. krahin. 2. fig. përmb. Njerëzit a kafshët që bëjnë dëm të madh ose që sjellin humbje të rënda. Hubia e prishi misrin shpendët dëmtarë e prishën misrin.
- ILEGALITET** m. 2. përmb. hist. Tërësia e organizatave që luftonin kundër pushtuesve të huaj dhe veglave të tyre në Shqipëri gjatë Luftës Nacionalçlirimtare duke punuar e vepruar në mënyrë konspirative (Partia Komuniste e Shqipërisë dhe organizatat e masave të udhëhequra prej saj). Njerëzit (luftëtarët, heronjtë) e ilegalitetit.
- IMIGRACION** m. 2. përmb. Njerëzit që kanë imigruar, tërësia e imigrantëve.
- INSTITUT** m. përmb. bised. studentët e punonjësit që bëjnë pjesë në një shkollë a në një qendër të tillë. Institut i lartë. Instituti bujqësor (pedagogjik, mjekësor). Institut kërkimor-shkencor. Instituti i shkencave (i arteve, i fizikulturës, i projektimit). Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Punonjësit e instituteve. Drejtori

- INTELIGJENCIE** f. përmb. intelektualët e një vendi. Inteligjencia popullore (përparimtare, revolucionare). Inteligjencia e re (e vjetër).
- ISLAMIZËM** m. 2. përmb. Tërësia e myslimanëve, myslimanët; bota islame.
- KALORËSI** f. 1. përmb. Tërësia e kalorësve, kalorësit.
- KATËR** num. them. 2. përmb. (të), KATRA (të). Katër njerëz, kafshë ose sende bashkë a menjëherë. Erdhën (që) të katër. Ikën (që) të katra.
- KATOLICIZËM** m. 2. përmb. Tërësia e katolikëve, katolikët.
- KLASË** f. përmb. bised. tërësia e nxënësve që ndjekin mësimet së bashku në një vit mësimor. Klasa e parë (e dytë, e tetë). Klasa paralele (kolektive). Klasat e ulëta (e larta). Shok klase. Kujdestari i klasës. Regjistri i klasës. Mbledhja e klasës. Lexim jashtë klase. Puna në klasë. Kreu klasën e tretë (e pestë, e gjashtë). Doli i pari i klasës. Përsërit klasën. Mbeti në klasë. E kaloi klasën. Hyri (u hodh) në klasën e katërt.
- KLER** m. përmb. Të gjithë ata që kryejnë shërbime fetare e që kanë detyra të ndryshme fetare (në vendet ku vepron feja). Kleri katolik (ortodoks, mysliman). Kleri i lartë. Vepërimtaria reaksionare e klerit.
- KOPERI** përmb. Të gjitha kopetë së bashku.
- KORRESPONDENCË** f. 2. përmb. Tërësia e letrave që merr dikush nga të tjerët, letrat që janë këmbyer ndërmjet dy njerëzve a institucioneve. U botua korrespondenca. Studioj korrespondencën e dikujt.
- KRESHKË** f. përmb. tërësia e gjetheve të një druri, fletët. I dolën kreshkat pemës. I ranë kreshkat mollës. U ra kreshka drurëve.
- KRESHNIKI** f. 2. përmb. Tërësia e kreshnikëve, kreshnikët. Kreshnikia e maleve.
- KRIMBËRI** f. përmb. 1. Tërësia e krimbave, krimbat.
- KUADËR** I m. zyrt. 1. përmb. Tërësia e punonjësve (e nëpunësve dhe e punëtorëve) të një ndërmarrjeje, të një institucioni etj.; edhe sh. secili nga këta punonjës që bën një punë të caktuar sipas organikës. Kuadri i institutit. Kuadrot teknike. Kuadri i mesëm kuadri me arsim të mesëm. Kuadrot e arsimit. Kuadrot me arsim të lartë. Lëvizja e kuadrit. 3. përmb. usht. Tërësia e ushtarakëve që kanë për detyrë përgatitjen luftarake e politike të trupave në një njësi ushtarake; edhe sh. secili nga këta ushtarakë. Kuadri i repartit.
- KUMBARI** f. etnogr. 2. përmb. Tërësia e kumbarëve, kumbarët. Erdhi kumbaria.
- KUMTËRI** f. përmb. etnogr. 1. Tërësia e kumtërve, kumbaria. U mblodh kumtëria.
- KUNETËRI** f. përmb. Tërësia, e kunetërve kunetërit. Jeton bashkë me kunetërinë. E ndihmoi kunetëria.
- KURA** f. vjet. 1. përmb. Djem të një moshe, që thirreshin njëherësh për të kryer shërbimin ushtarak. U ngritën (u thirrën) dy kura menjëherë.
- KURORË** f. përmb. familja mbretërore. Kurora mbretërore. Kurora e perandorit (e mbretëshës). Pasuritë e kurorës. Fjalimi i kurorës fjalimi i mbretit në parlament në disa vende borgjeze.
- KURS** m. përmb. bised. ata që ndjekin këto mësimet. Kurs teknik. Kurs tremujor (gjashtëmujor, njëvjeçar). Kurs kualifikimi. Kurs kundër analfabetizmit. Kursi i ekonomisë shtëpiake. Kurs për kuzhinierë (për mami, për infermierë, për rrobaqepëse, për traktoristë, për shoferë). Kurs pa shkëputje nga puna. Erdhi gjithë kursi. 3. Viti mësimor që ndjek dikush në një shkollë të lartë sipas një programi të caktuar; përmb. bised. tërësia e studentëve që ndjekin mësimet së bashku në një vit të tillë. Kursi i parë

- (i dytë ...). Shok (shoqe) kursi. Në ç'kurs bëhet kjo lëndë? Kursi i tretë ka provim. Mori pjesë (kaloi) i gjithë kursi.
- KUSARI** f.
2. përmb. Grup kusarësh; tërësia e kusarëve, kusarët.
- KUSHËRINI** f. 1. përmb. Tërësia e kushërinjve, kushërinjtë. Erdhi (u mblodh) kushërinia.
- KUVEND** m. përmb. të gjithë ata që merrnin pjesë në këtë mbledhje. Kuvendi i burrave. U mblodh kuvendi. E shtruan në kuvend. E vendosi kuvendi. përmb. të gjithë ata që marrin pjesë në një mbledhje të tillë. Kuvend historik. Kuvendi i malësisë. Kuvendi i grave. U mblodhën në kuvend. Foli në kuvend.
- KUZHINË** f. përmb. gjellët e gatuar sipas kësaj mënyre; gjellët me karakteristike për një popull. Kuzhinë e mirë (e lehtë). Kuzhina shqiptare. Kuzhina evropiane (orientale). Arti i kuzhinës.
- LADUTËRI** f. bised. 3. përmb. Llupësit, grykësit, makutët. S'la gjë në sofër ladutëria. 4. përmb. Njerëzit shpirtkëqij e grabitqarë, të pabesët. U mblodh gjithë ladutëria.
- LAGUSH** m. përmb. Gjethe drurësh që kanë rënë në ujë ose në tokë të lagët dhe janë njomur e kalbëzuar; gjethe që sjellin ujërat; pleh prej gjetesh të kalbura. Mblodhën lagush në pyll. I hodhën lagush arës.
- LAMASHËRI** f. keq. 2. përmb. Tërësia e njerëzve lamashë. U mblodh lamashëria.
- LINDJE** f. përmb. Njerëzit e barkut të vet, pasardhësit; trashëgimtarët. Mamia pret lindjet. Thirri gjithë lindjen e vet.
- LUARI** f. përmb. Kope lopësh.
- LUKËR** f. 1. Dele; qengj; përmb. tufë e vogël dhensh.
- LYPËSI** f. 2. përmb. Tërësia e lypësve, lypësit.
- MALËSI** f. 2. përmb. Malësorët. U mblodh malësia. E dha fjalën (besën) malësia.
- MANIFAKTURË** f. 2. përmb. vjet. Stofra a pëlhura të prodhuara nga fabrikat e tekstileve. Dyqan manifakture.
- MASHKULLI** f. 2. përmb. Tërësia e meshkujve, djemtë dhe burrat; kund. grari. Erdhi gjithë mashkullia.
- MATURË** f. 2. përmb. edhe sh. A, AT bised. Tërësia e nxënësve të klasës së fundit të një shkolle të mesme. Matura u nis për në aksion.
- MERCENARI** f. libr. 1. përmb. Tërësia e mercenarëve, mercenarët.
- MESHTARI** f. fet. 2. përmb. Tërësia e meshtarëve, meshtarët. Mbledhja e meshtarisë.
- MËRGATË** f. përmb. Njerëzit e mërguar në dhe të huaj, mërgimtarët. Mërgata shqiptare e Misirit.
- MILICI** f. 2. përmb. Organe ndihmëse të policisë në disa vende të tjera; policia në disa vende. Oficer i milicisë.
- MIQËSI** f. 3. përmb. Gjithë miqtë e dashamirët; njerëzit e afërm. Erdhi (u mblodh) miqësia. Thirri miqësinë në gosti.
- MISËRI** f. përmb. bised Tërësia e arave të mbjella me misër, misrat. U bë mirë misëria sivjet.
- MITURI** f. 4. përmb. Tërësi e të miturve, të miturit. Erdhi mituria. Vajzë e vogël, vajzë e mitur.
- MIZËRI** f. përmb. 1. Shumicë e madhe, mori (njerëzish, kafshësh a sendesh). Mizëri e madhe. Mizëri ushtarësh. Mizëri kafshësh. Një mizëri çadrash. 2. përd. ndajf. Shumë, plot; me shumicë. Erdhën mizëri. Kishte mizëri.
- MOBILIERI** f. 1. përmb. Tërësia e mobilieve të një shtëpie, të një zyre etj., mobiliet. Fabrika e mobilierisë. Reparti (dyqani) i mobilierisë. E pajisën me mobilieri.

- MOTËRI** f. përmb. Të gjitha motrat së bashku, motrat. U mbledh (erdhi) motëria.
- MURGJËRI** f. përmb. Tërësia e murgjve, murgjit. U mbledh murgjëria.
- MYSLIMANIZËM** m. 2. përmb. Tërësia e myslimanëve, myslimanët, bota myslimane.
- NDRIKULLI** f. 1. përmb. Tërësia e ndrikullave, gjithë ndrikullat së bashku. Na erdhën ndrikullat.
- NËNËRI** f. 2. përmb. Të gjitha nënat së bashku, nënat.
- NIPËRI** f. përmb. Tërësia e nipave, nipërit. Erdhi me gjithë nipërinë.
- NUMIZMATIKË** f. 2. përmb. Tërësia e monedhave të një periudhe historike. Numizmatika ilire.
- NUNËRI** f. 2. përmb. Tërësia e nunëve. Erdhën nunëria.
- NUSËRI** f. 2. përmb. Tërësia e nuseve, të gjitha nusët e një vendi. Nusëria e fshatit. U mbledh gjithë nusëria.
- NJERËZI** përmb. 1. Të gjithë njerëzit e një vendi së bashku; një grumbull njerëzish; njerëzit, bota, gjindja. I dha dritë njerëzisë. I bëri zë njerëzisë. Doli faqebardhë para njerëzisë. Po mblidhej njerëzia.
- NJERËZIM** m. përmb. Tërësia e njerëzve që rrojnë në Tokë, gjithë njerëzit e botës; shoqëria njerëzore, njerëzit. Njerëzimi përparimtar. E ardhmja e njerëzimit. Historia e njerëzimit.
- OBORRTARI** f. 1. përmb. Njerëzit e shtresave të larta që mban rreth vetes monarku, rrethi i ngushtë i mbretit a i perandorit.
- OLIGARKI** f. përmb. grupi i vogël sundues në këtë formë qeverisjeje. Oligarkia skllavopronare (aristokrate). Lufta kundër oligarkisë. përmb. pronarët e monopoleve të mëdha që bëjnë pjesë në këtë grup dhe që nxjerrin fitime të shumta duke shfrytëzuar egërsisht masat e gjera punonjëse në vendet kapitaliste, si edhe vendet e prapambetura. Oligarkia financiare.
- OPTIKË** f. 1. Degë e fizikës, që studion dritën, vetitë e ligjet e saj si edhe ligjet e të parit. Ligjet e optikës.
2. përmb. tek. Tërësia e mjeteve dhe e veglave që janë të pajisura me thjerrëza të ndryshme. Optika e projektimit.
- ORTAKËRI** f. 1. Bashkëpunimi ndërmjet ortakëve, të qenët ortak me dikë tjetër. Bëri ortakëri me të. E prishi ortakërinë. E nxori nga ortakëria.
2. përmb. Tërësia e ortakëve, ortakët.
- ORTODOKSI** f. 2. përmb. Tërësia e ortodoksëve, ortodoksët.
- OSHËNARI** përmb. fet. 1. Tërësia e oshënarëve. Vendi (pylli) i oshënarisë.
- OXHAKËRI** f. përmb. hist. Njerëzit e shtresës së pasur; klasa feudale e vendit, paria feudale. Oxhakëria e vendit.
- OXHAKËSI** f. përmb. hist. shih OXHAKËRI, A.
- PALAVI** f. 3. përmb. Barërat e këqija, që mbytin bimët e mbjella. E ka mbytur grurin (misrin) palavia.
- PALLAT** m. 3. përmb. Perandori a mbreti me rrethin e tij të ngushtë, oborri perandorak a mbretëror. Jeta e shthurur (orgjitë) e pallatit. Merrnin miratimin e pallatit. Ishin njerëzit e pallatit.
- PARËSI** f. 1. përmb. vjet. Paria. Parësia e vendit.
- PARFUMERI** f. 1. vet. nj. përmb. Tërësia e lëngjeve me erë të mirë dhe e lëndëve të tjera për kozmetikë; vet. sh. lloje të ndryshme parfumeshe e lëndësh të tjera për kozmetikë. Prodhimi i parfumerive.
- PARI** f. përmb. Shtresa më e pasur dhe më e lartë e shfrytëzuesve; përfaqësuesit e kësaj shtrese që sundojnë një vend a një krahinë; krerët e vendit (në vendet me

- rend shfrytëzues); kund. vegjëli. Paria fisnore. Paria e vendit (e qytetit, e fshatit). Vendoste paria.
- PAZAR** m. bised. 2. përmb. Tërësi e njerëzve që shesin a blejnë në këtë vend; grumbull i madh e i çrregullt njerëzish. U mblodh pazari.
- PEMËTARI** f. 2. përmb. Tërësia e drurëve frutorë që mbillen e rriten nga njeriu, pemët. Pemëtaria duket e mbarë sivjet.
- PESË** num. them. 2. përmb. (të), PESA (të). Pesë së bashku a menjëherë. Erdhën të pesë (vëllezërit).
- PËRCJELLË** përmb. Ata që i shkojnë prapa një njeriu të shquar dhe e shoqërojnë kur shkon diku, shpurë.
- PËRFAQËSI** f. 1. përmb. Tërësia e atyre që janë zgjedhur në një organ shtetëror, shoqëror etj. për të mbrojtur të drejtat e një grupi njerëzish, për të marrë vendime në emër të shumicës etj., tërësia e përfaqësuesve të zgjedhur. Përfaqësi e zgjedhur nga populli. Përfaqësia e krahinës së Vlorës. Vendimi i përfaqësisë së kooperativës.
- PIRATËRI** f. 3. përmb. Tërësia e piratëve.
- PLAÇKË** f. 1. edhe përmb. Tërësia e sendeve dhe e orendive shtëpiake, pasuri e mall që ka dikush në shtëpi; zakon. sh. rrobat e sendet e tjera vetjake, që merr me vete dikush kur udhëton ose kur largohet nga shtëpia, tesha. Vuri (bëri, mblodhi) shumë plaçkë. Kishte plaçkë të madhe. Plaçkat e shtëpisë. Plaçkat e udhëtimit. Plaçkat e nuses. Një valixhe (një bohçe) me plaçka. Mblodhi plaçkat. Mori pak plaçka me vete. Ngarkoi (solli) plaçkat.
- PLATE** f. përmb. bised. njerëzit që rrinë në këtë pjesë. Plateja e teatrit. U ulën (zunë vend) në plate. U ngrit më këmbë gjithë plateja.
- PLEQËRI** f. 2. përmb. Tërësia e pleqve, pleqtë. U mblodh pleqëria.
- PLEQËSI** f. 1. përmb. hist. Këshill burrash, të zgjedhur në një fshat a në një lagje, që vendosnin për punët e fshatit a të lagjes, pajtonin gjaqet, zgjidhnin mosmarrëveshjet etj.; organ këshillues i pushtetit shtetëror në një krahinë që përbëhej prej njerëzve të parisë; kuvendi i pleqve. Pleqësia kombëtare. Pleqësia e fshatit. Pleqësia dhe vegjëlia.
- PLUTOKRACI** f. libr. 2. përmb. Tërësia e plutokratëve, plutokratët.
- PLLENIM** m. 2. përmb. Bagëtia që ka pjellë, kafshët pëllezja. Ndajnë pllenimin nga shterpëria (nga shterpat).
- POÇERI** f. përmb. Tërësia e poçeve dhe e enëve të tjera prej balte. Poçeria e hollë enë prej fajance. Poçeri e trashë.
- PRAPAMAL** m. 2. përmb. Banorët e kësaj krahine, prapamalasit, tejmalasit. U turr (u ngrit më këmbë) i gjithë prapamali.
- PRESIDIUM** m. përmb. tërësia e njerëzve që bëjnë pjesë në një organ të tillë. Anëtarët e presidiumit. Dekretet e presidiumit.
- PRIFTËRI** f. 2. përmb. Tërësia e priftërinjve, priftërinjtë.
- PRITË** II f. 2. përmb. Grupi i njerëzve që përgojnë në një vend të fshehtë për të sulmuar dikë në befasi. Prita partizane.
- PRODHIM** m. përmb. tërësia e vendeve a e qendrave ku kryhet kjo punë. Brigada e prodhimit. Njësi prodhimi. ek. Njerëzit e prodhimit. Mjeshtër prodhimi. Qendër prodhimi. Propaganda e prodhimit. Revolucionarizimi i prodhimit. Ritmet e prodhimit. Futja e shkencës dhe e teknikës së përparuar në prodhim. Lidh mësimin me prodhimin. Punë në prodhim. Punon në prodhim. Kaloi në prodhim. Vjen nga prodhimi. E kryen stazhin në prodhim.
- PRUSH** m. 5. përmb. Thekët e sixhadesë, të velenxës etj. Velenxë me prush.
- QENËRI** f. përmb. 1. Tërësia e qenve, qentë. Ulërijnë qenëria.

- QERAMIKË** f. 2. përmb. Enë, tjegulla, sende zbukurimi etj., të bëra prej deltime të mbrujtur e të pjekur në furrë. Qeramikë e zakonshme tulla, tjegulla etj. Qeramikë e hollë sende prej porcelani. Qeramikë artistike. Qeramikë e pikturuar. Punimi i qeramikës. Bojë qeramike.
- QIME** f. 2. përmb. Tërësia e fijeve të holla që mbulojnë trupin e një kafshe. E ka qimen të zezë (të kuqe, të murrme). E ka qimen të ashpër (të butë). Ndërron qimen. I bie qimja. Ujku qimen e ndërro, po lëkurën s'e ndërro (po zakonisht s'e harron). fj. u.
3. përmb., bised. Fijet e mjekrës e të mustaqeve. E ka qimen të ashpër (të fortë). S'i ka dalë (dihur) qimja ende nuk ka filluar ende të rruhet, është ende i mitur.
- QYTET** m. 2. përmb. Banorët e një qendre të tillë; jeta, mënyra e jetesës në një qendër të tillë.
- RAJA** f. përmb. fshatarësia e varfër, vegjëlja. Ngriti krye rajaja.
- REAKSION** II m. 2. përmb. Forcat e klasave shfrytëzuese, që ndjekin këtë politikë ose që kanë vendosur një regjim të tillë; kundërrevolucionarët, reaksionarët. Reaksioni i jashtëm (ndërkombëtar, i brendshëm). Forcat e reaksionit. Qendra e reaksionit. Krerët e reaksionit. Lufta kundër reaksionit. E shpartalluam reaksionin.
- REGJI** f. teatër., kinem. 2. përmb. Tërësia e punonjësve që drejtojnë vënien në skenë të një shfaqjeje ose të një filmi, regjisorët. Puna e regjisë.
- REPART** m. përmb. bised. tërësia e punonjësve të kësaj ndarjeje. Repartet ndihmëse (kryesore). Reparti i shkrirjes (i derdhjes, i petëzimit, i tjerjes, i qëndisjes, i larjes). Reparti i rrobaqepësisë (i zdrukthëtarisë, i shërbimeve). Reparti i tezgjahut (i tornove). Reparti i lodrave (i këpucëve). Repartet e uzinës (e fabrikës, e dyqanit). Përgjegjësi i repartit. Mbledhja e repartit. Punojnë në një repart.
- RESHPERI** f. vjet. 2. përmb. Tërësia e tregtarëve, tregtarët.
- REZERVË** f. 3. përmb. usht. Pjesë e qytetarëve, që zakonisht e kanë bërë shërbimin ushtarak dhe që vazhdojnë përgatitjen për periudha të shkurtra ose që thirren nën armë në rast nevojë. Ushtar (oficer) i rezervës. Thirrja e rezervës. Stërvitja e rezervës. Dali në rezervë.
- RINI** f. 3. përmb. Tërësia e të rinjve dhe e të rejave, gjithë të rinjtë e të rejt; brezi i ri. Rinia shqiptare. Rinia punëtore (fshatare, shkollore). Rinia e botës. Edukimi i rinisë. Program (emision) për rininë.
- ROBËRI** f. 3. përmb. bised. Njerëzia; tërësia e njerëzve të shtëpisë.
- ROBI** f. përmb. krahin. Tërësia e njerëzve, njerëzit.
- ROJË** f. 3. përmb. Njësi ose trupë e vogël ushtarake, e caktuar për të kryer shërbimin e patrullimit, të mbikëqyrjes dhe të ruajtjes së diçkaje, vendi i qëndrimit të kësaj njësie. Trupi i rojës. Vendi i rojës. Oficeri (komandanti) i rojës. Ndërron rojën.
- RREGULLI** f. përmb. Gjak e gjiri, farefis.
- RRËMET** m. 2. vet. nj. përmb. Njerëzit, gjindja; turmë njerëzish. U mblodh rrëmeti. Kaloi përmes rrëmetit. Ç'është gjithë ky rrëmet këtu!
- RRUNGAJË** f. përmb. drurë, gurë e dhe që shemben nga mali a që sjell lumi me vete. Nuk sjell lumi gjithnjë rrungaja. fj. u.
- SALLAMERI** f. 2. vet. nj. përmb. Tërësia e llojeve të ndryshme të sallameve.
- SALLË** f. 2. përmb. Njerëzit që marrin pjesë në një mbledhje që bëhet në një dhomë të tillë. Përgjigje nga salla. Iu drejtua sallës. Ngriti sallën më këmbë.
- SEKRETARI** f. sh 2. vet. nj. përmb. Tërësia e sekretarëve të zgjedhur për të mbajtur procesverbalet e një mbledhjeje, të një konference etj. Tryeza e sekretarisë. U zgjodh presidiumi dhe sekretaria.

- SERMAJË** f. përmb. vjet. 1. Para të vëna mënjanë, pasuri, kapital. E humbi tërë sermajën.
- SIMBOLIKË** f. libr. 2. përmb. Tërësia e simboleve të një shkencë. Simbolika e algjibrës (e kimisë).
3. përmb. Tërësia e simboleve të përdorura në një vepër letrare ose artistike, ose nga një autor a nga një drejtim letrar, artistik, shoqëror etj. Simbolika e Nolit. Simbolika e romantizmit.
- SKOTË** f. 2. përmb. Tërësi njerëzish me prejardhje të njëjtë si familje, si soj a si racë. Skota njerëzore. S' është nga ajo skotë.
- SKULPTURË** f. 3. vet. nj. përmb. Tërësia e veprave artistike të tilla të një mjeshtri, të një periudhe a të një drejtimi. Skulptura ilire.
- SMUQTH** m. përmb. Rropullitë, të brendshmet, përbrendësata.
- SOFËR** f. 2. përmb. Tërësia e të ftuarve që ulen njëherësh rreth një tryezë në një dasmë, gosti etj. Sofra e grave (e burrave, e fëmijëve). Dy sofra burra e tri sofra gra. Tri sofra me të ftuar.
- SPIUNAZH** m. 2. përmb. Rrjeti i spiunëve të një vendi. Spiunazhi amerikan (sovjetik).
- SULM** m. përmb. lojtarët e vijës së parë të skuadrës që kanë për detyrë të bëjnë këto veprime. Sulme të rrezikshme (të rrufeshme). Vija e sulmit. Sulm në krahun e djathtë. Organizojnë sulme pas sulmesh. Kaloi nga mbrojtja në sulm.
- SHKALLË** f. përmb. bised. të gjitha apartamentet që ndodhen në këtë hyrje dhe njerëzit që banojnë në të. Shkalla e parë (e dytë...). Ndërtesë me tri shkallë. Mbledhja e shkallës. Përgjegjësi i shkallës. Në cilën shkallë banon? Shkalla 5, apartamenti 12.
- SHKOLLË** f. përmb. bised. tërësia e nxënësve dhe e punonjësve të këtij institucioni. Shkollë fillore (tetëvjeçare, e mesme, e lartë). Shkollë industriale (bujqësore, pedagogjike, ushtarake). Shkollë normale. vjet. Shkollë qytetëse. vjet. Shkollë unike. vjet. Shkollë ushtrimore. Shkollë e ditës. përmb. tërësia e atyre që ndjekin një drejtim të tillë. Shkollë letrare (filozofike). Shkolla romantike (klasike, realiste). Shkollë materialiste (idealiste). Shkolla e piktorëve mesjetarë shqiptarë (e Onufrit). Shkolla e fjalëve dhe e sendeve. gjuh.
- SHKURRE** f. bot. 2. përmb. Pyll i imët, imshhtë; shkorret.
- SHPENDI** f. përmb. Shpesëri. Puplat e shpendisë. Ra shpendia nëpër ara.
- SHPESËRI** f. përmb. Tërësia e shpendëve, shpendët. Shpesëria e egër. Iku shpesëria.
- SHPEZËRI** f. përmb. Shpesëri. Fle e ngrihet me shpezërinë.
- SHQIPTARI** f. 1. përmb. Tërësia e shqiptarëve, populli shqiptar. U çua shqiptaria.
- SHTATË** num. them. 2. përmb. (të), SHTATA (të). Shtatë së bashku a menjëherë. Dolën të shtatë nxënësit (të shtata nxënëset). I lexova të shtatë vëllimet.
- SHTAZËRI** f. 1. përmb. Tërësia e shtazëve, shtazët, kafshëria. U largua shtazëria.
- SHTEGTARI** f. 1. përmb. Tërësia e shtegtarëve që bëjnë një rrugë së bashku, shtegtarët.
- SHTERPËRI** f. 1. përmb. Bagëtitë shterpa (zakonisht për dhentë e dhitë). Për mish kishin shterpërinë. Shterpërinë e ndanë veç.
- SHTERPËRIM** m. 2. përmb. krahin. shih SHTERPËRI, A 1.
- SHTERPIM** m. 2. përmb. krahin. shih SHTERPËRI, A 1.
- SHTJERRI** f. përmb. 1. Tërësia e qengjave dhe e kecape, qengjat e kecat së bashku, tufë qengjash e kecash. Mbledhin (ndajnë) shtjerrinë. Kullot shtjerrinë.

- TEKNOKRACI** f. 2. përmb. Tërësia e teknokratëve, teknokratët. Pushteti i monopoleve dhe i teknokracisë. Në duart e teknokracisë.
- TERREN** m. 2. përmb. Ndërmarrjet e prodhimit të rrethit, kooperativat bujqësore dhe institucionet lokale kundrejt qendrës dhe institucioneve qendrore; bazë.
- TRE** m. num. them. 2. përmb. TRE (të), TRIA (të). Tre ose tri së bashku a menjëherë. Erdhën të tre shokët (të tria shoqet).
- TRI** f. num. them. 2. përmb. TRE (të), TRIA (të). Tre ose tri së bashku a menjëherë. Erdhën të tre shokët (të tria shoqet).
- TRUP** m. 6. përmb. Grup njerëzish që kanë punë të njëjtë a detyrë të përbashkët dhe që përbëjnë një kolektiv, një administratë, një institucion etj. Trupi diplomatik përfaqësuesit e shteteve të huaja të akredituar në një shtet. Trupi gjykues kryetari i gjyqit së bashku me anëtarët. Trupi mësimor (pedagogjik) tërësia e arsimtarëve të një shkolle; të një fakulteti etj. Trupi mjekësor mjekët.
- TURQËRI** f. përmb. bised. Turqit. Skënderbeu e dërrmoi turqërinë.
- THARK** m. 6. përmb. bised. Tërësia e pjellave të një viti të caktuar, bark, brez (për kafshët e për njerëzit); tërësia e fëmijëve që kanë lindur gjatë martesës me një grua të caktuar.
- THJESHTËRI** f. përmb. Tërësia e djemve të gjetur dhe e vajzave të gjetura, thjeshtit e thjeshtat.
- UDHËHEQJE** f. 4. përmb. Tërësia e drejtuesve, udhëheqësit; organi udhëheqës. Udhëheqje e sprovuar. Udhëheqje besnike. Udhëheqja kooperativës (e ndërmarrjes, e ministrisë, e shkollës). Përbërja e udhëheqjes. Detyrat e udhëheqjes. Zgjedhën udhëheqjen. E sollën (e zgjedhën) në udhëheqje. Doli në udhëheqje.
- UJQËRI** f. përmb. Tërësia e ujqve, ujqit.
- UNIVERSITET** m. përmb. bised. studentët dhe punonjësit që bëjnë pjesë në të; ndërtesa e kësaj shkolle. Studentët (pedagogët, punonjësit) e universitetit. Diplomë universiteti. Godinë e universitetit. Sallat (auditorët) e universitetit. Laboratorët e universitetit. Mbaroi (kreu) universitetin. Hyri (u regjistrua) në universitet. Parakaloi universiteti.
- URTI** f. 2. përmb. etnogr. vjet. Këshilli i pleqve, që jepte mendim për një çështje sipas përvojës dhe zakoneve të vendit; pleqësi. E hodhën (e qitën) në urti punën.
- VAJ** I m. 3. përmb. Bojëra në ngjyra të ndryshme, që përpunohen me lëngje të tilla dhe që përdoren për pikturë. Pikturë në vaj.
- VAJZËRI** f. 3. përmb. Tërësia e vajzave, vajzat e një vendi, çupëri. Vajzëria e fshatit. Erdhi gjithë vajzëria. Ishte mbledhur tërë vajzëria.
- VARFËRI** f. 5. përmb. vjet. Tërësia e njerëzve të varfër, të varfrit. U mblodh varfëria.
- VEGLËRI** f. përmb. Tërësia e veglave, veglat që përdoren për të bërë një punë a për një veprim. Veglëri vizatimi. Veglëri për ndezje minash.
- VEGJËLI** f. 1. përmb. Shtresat e gjera e të varfra të popullit punonjës, njerëzit e thjeshtë e të varfër kundrejt të pasurve e shfrytëzuesve; masa (në vendet me rend shfrytëzues); kund. pari. Vegjëlia shqiptare. Vegjëlia e qytetit (e fshatit). Interesat e vegjëlisë. Lufta e vegjëlisë. Zëri i vegjëlisë. Shtypet (shfrytëzohet) vegjëlia. Ngriti krye vegjëli.
- VEND** m. 13. përmb. Tërësia e njerëzve që banojnë a që jetojnë diku, njerëzit, gjindja e një fshati, e një qyteti, e një krahine, e një shteti etj.; populli, popullsia. Luftonte vendi për liri. U ngrit i gjithë vendi. Mblodhi tërë vendin. S'e donte vendi. U tund vendi.

- VEPËR** f. 4. përmb. Tërësia e atyre që ka krijuar dikush në fushën e artit, të letërsisë, të shkencës etj.; krijimtaria e dikujt. Vepër e pavdekshme. Vepra e një shkrimtari. Vepra e Naim Frashërit. Vepra e Aleksandër Xhuvanit.
- VESHMBATHJE** f. përmb. Rrobat, çorapet e këpucët që përdorim për t'u veshur e për t'u mbathur. Veshmbathje pune. Dyqani i veshmbathjes. Industria e veshmbathjes. Sektori i veshmbathjes.
- VËLLAMËRI** f. etnogr. 2. përmb. Tërësia e vëllamëve, vëllamët. U mbledh vëllamëria.
- VËLLAZËRI** f. 1. përmb. Tërësia e vëllezërve, vëllezërit. U mbledh (erdhi) vëllazëria.
- VËLLAZËRIM** m. 2. përmb. shih VËLLAZËRI, A 1.
- VJEHËRRI** f. 2. përmb. Vjehri dhe vjehrra së bashku.
- XUNKTH** m. sh 2. vet. nj. përmb. Kërcejtë e tharë të kësaj bime, që përdoren për thurje, për fshesa etj. Shportë (karrige, kolltuk) xunkthi. Prodhime xunkthi. Fshesë xunkthi. Çati me xunkth. Reparti i xunkthit. Thur me xunkth.
- XHAKONI** f. fet. 2. përmb. Tërësia e xhakonëve, xhakonët.
- XHANDARMËRI** f. përmb. Trupa ushtarake të veçanta në vendet borgjeze (para Çlirimit edhe në Shqipëri) që përdoren për të mbrojtur rendin shtetëror në fuqi, për të shtypur lëvizjet demokratike e revolucionare dhe për disa detyra të policisë gjyqësore; ndërtesa me zyrat e këtyre trupave. Forcat e xhandarmërisë. Zyrat e (kazermat) e xhandarmërisë. Repartet e xhandarmerisë. Postat e xhandarmërisë. Togër(komandant) i xhandarmërisë. E thirren e (mbajtën) në xhandarmëri.
- ZEJTARI** f. 2. përmb. Tërësia e zejtarëve.